

votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” .

3. Shfuqizimin e këtyre vendimeve, duke vendosur: Ndryshimin e përmbajtjes së Fletës së Votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 61 bashkitë e vendit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, duke hequr logon e partive dhe/pse të koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për kandidatës për kryetar bashkie.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 51 regj., datë 18.04.2023. Në mbledhjen e datës 18.04.2023, ora 18:15, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 51 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Në seancën paraprake, z. Indrit Sefa, si përfaqësues i “Partisë Demokratike të Shqipërisë” kërkoi të jetë pjesë e këtij shqyrtimi si palë e interesuar. Z. Sefa arriti të provojë interesin e tij të ligjshëm, si palë e tretë. KAS-i vendosi ta pranojë këtë kërkesë.

Pala e interesuar ngriti pretendimin se kërkesa ankimore është bërë përtej afatit ligjor, pasi vendimmarrja e Komisionerit mban orën 10:00, të datës 15.04.2023 dhe kërkesa është depozituar në orën 15:55, datë 18.04.2023.

KAS-i e rrëzoi kërkesën për deklarin jashtë afatit, me arsyetimin se afati i përcaktuar për ankimim nga Kodi Zgjedhor përllogaritet me ditë dhe jo me orë. Afati ka filluar në datën 16.04.2023 dhe përfundon me datë 18.04.2023 Kërkesa ankimore nr. 51 nga koalicioni “Bashkë Fitojmë” është paraqitur brenda afatit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 51, datë 18.04.2023, të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 19.04.2023, ora 17:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar